

INA ARAPI

**NJË MONOGRAFI E JOACHIM MATZINGER-IT
JOACHIM MATZINGER, *DIE SEKUNDÄREN NOMINALEN
WORTBILDUNGSMUSTER IM ALTALBANISCHEN BEI GJON
BUZUKU. EIN BEITRAG ZUR ALTALBANISCHEN LEXIKOGRAPHIE,
ALBANISCHE FORSCHUNGEN BAND 38, HARRASOWITZ
VERLAG, WIESBADEN, 2016.***

Para disa muajsh, studimet buzukiane, si dhe ato për leksikun historik të shqipes, u pasuruan me një monografi të re e të thelluar të albanologut austriak Joachim Matzinger rreth mënyrave dhe mjeteve të formimit të emrave e mbiemrave në dokumentet më të hershme të shqipes së shkruar. Duke qenë e para vepër e shtypur në gjuhën shqipe që njohim deri më sot, Meshari i dom Gjon Buzukut ka qenë objekt studimi dhe burim parësor të dhënash për çdo gjuhëtar që merret me historinë e kësaj gjuhe. Dhe kjo është e kuptueshme, po të kujtojmë se kemi të bëjmë me një vepër të vëllimshme, pjesërisht ose tërësisht përkthim prej teksteve të tjera ende të papërcaktuara, me një gjuhë të pasur dhe strukturë komplekse. Kështu, gjuha shqipe, megjithëse e dokumentuar vonë, na shfaqet që në fillim me një monument të madh gjuhësor që na lejon të studiojmë gjerësisht aspekte të ndryshme të saj dhe të nxjerrim konkluzione të bazuara.

Duhet thënë këtu që studimet e vazhdueshme po tregojnë gjithnjë e më qartë se gjuha e veprës së Gjon Buzukut përfaqëson një të folme të vjetër edhe për kohën kur u shkrua. Vitet e fundit është kristalizuar ideja se kjo vepër, të cilës fatkeqësisht i mungojnë 32 faqe, midis tyre edhe frontespici në ekzemplarin e vetëm që ruhet në Bibliotekën e Vatikanit, duhet të jetë botuar në Venedik, ku vepronte një komunitet shqiptar shumë i fuqishëm.¹ Historiana italiane, Lucia Nadin, ka bërë kërkime të hollësishme dhe ka gjetur të dhëna të besueshme që e mbështesin këtë ide. Për herë të parë në historinë e studimeve albanologjike edhe studiuesi Matzinger në veprën në fjalë e ka pranuar si të mirëqenë këtë fakt duke shënuar në fq. 42: Gjon Buzuku 1555 (Venedig). Ka gjithashtu mendime sipas të cilave Buzuku jo vetëm e ka botuar, por edhe e ka shkruar në diasporë doracakun e tij për një komunitet që ishte larguar prej një kohe të papërcaktuar nga atdheu dhe që ruante ende gjuhën e marrë me vete. Përveç këtyre fakteve historike edhe studimet gjuhësore të deritanishme dëshmojnë për një të folme shqipe shumë

¹ Shih për këtë studimin bazal të Lovorka Čoralić (Zagreb) *Nga Ulqini deri në Durrës – emigrantët shqiptarë në Venedik (Shekulli XIV-XVIII)*, te “Poeta nascitur, historicus fit – ad honorem Zef Mirdita” (St. Gallen-Zagreb 2013, botues Albert Ramaj).

të vjetër, më të vjetër sesa Formula e Pagëzimit që i përket vitit 1462². Prandaj, ndonëse i botuar më 1555, libri i Buzukut pasqyron shtresa më të hershme të gjuhës shqipe, ashtu sikurse sot të folme të ndryshme mund të përmbajnë elemente arkaike, të cilat nuk i gjejmë në gjuhën e përditshme. Për këtë arsye kjo veper mbetet një burim i çmuar të dhënash për historinë e gjuhës shqipe.

Pas viteve '90 në artikuj e punime të ndryshme janë trajtuar çështje që lidhen sidomos me morfologjinë e etimologjinë e fjalëve të gjuhës shqipe, ashtu siç dëshmojnë ato të Meshari. Dy studime bazale në këtë drejtim, që i kushtohen tërësisht kësaj veprë, na vijnë nga albanologjia gjermanishtfolëse dhe janë “Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)” / Sistemi foljor i shqipes në gjuhën e Gjon Buzukut (1555) nga W. Fiedler, një studim jete prej 812 faqesh i autorit, që u botua në origjinalin gjermanisht në Prishtinë, në vitin 2004, si dhe vepra e sapobotuar e J. Matzingerit me titull “Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im Altalbanischen bei Gjon Buzuku” / Modelet e fjalëformimit emëror sekondar të shqipes së vjetër të Gjon Buzuku (2016, seria Albanische Forschungen 38, Shtëpia Botuese Harrassowitz, 593 fq.). Monografia e Fiedlerit është një studim i hollësishëm për sistemin foljor të Mesharit, ndërsa pjesa e dytë e saj përfshin një listë të të gjitha formave foljore që gjenden në këtë veper. Kjo pjesë, pra lista e formave foljore, u plotësua për autorët pasardhës (Matrënga, Budi, Bogdani, Variboba) në të njëjtën formë në veprën “Die Verben des Altalbanischen - Belegwörterbuch, Vorgeschichte und Etymologie” / Foljet e shqipes së vjetër – format, zhvillimi historik dhe etimologjia” (2013, seria Albanische Forschungen 33, Shtëpia Botuese Harrassowitz), 1055 faqe, nga studiuesit S. Schumacher dhe J. Matzinger. Këto vepra të rëndësishme, të botuara dhjetëvjeçarim e fundit, së bashku me studimet e veçanta në këtë fushë, e qartësojnë edhe më tej materialin primar të shqipes dhe kontributin e saj në fushën e studimeve indoevropiane.

Tani, vepra e dytë e madhe e J. Matzingerit për historinë e gjuhës shqipe u kushtohet modeleve ose mënyrave që janë përdorur në veprën e Gj. Buzukut për formimin e emrave e mbiemrave sekondarë ose jo të parmë.³ Përhapja e këtyre njësive leksikore është ndjekur edhe në vepra të tjera të letërsisë së vjetër shqipe, çka është e rëndësishme në radhë të parë për të vrojtuar aktivitetin e çdo modeli të veçantë fjalëformimi në shqipen e vjetër. Për

² Krahaso trajtën primare *u* të përemrit vetor të vetës së parë njëjës të përdorur nga Buzuku me trajtën e zgjeruar *Vn* (*u* + *-në*) të Formula e Pagëzimit. Shtesa *-n* <*-në* është relativisht e re, e një periudhe kur nuk vepronte më rotacizmi përndryshe *-n-* do të ishte kthyer në *-r-* (krh. Çabej 2006: 186).

³ Për sqarimin e termit leksik sekondar shih shpjegimet që jepen mbi kapitullin e pestë.

pasojë, rezultati është një pamje e përgjithshme për modele të caktuara fjalëformimi të emrave e mbiemrave në shqipen e shek. XVI-XVIII, sigurisht jo i të gjitha modeleve të fjalëformimit, pasi autori nisat nga ai inventar i emrave e mbiemrave që na paraqiten te Buzuku.

Gjuha, si mjete i vetëm që realizon komunikimin midis qenieve njerëzore, është një sistem tejet kompleks, kurse mënyra se si një gjuhë i krijon njësitë e reja të nevojshme për komunikimin njerëzor përbën padyshim një nga aspektet më të rëndësishme dhe më magjepsëse të këtij sistemi. Matzingeri e quan fjalëformimin në parathënie si “padyshim fushën më dinamike të gjuhës”. Duke analizuar sistemin fjalëformues të një gjuhe arrijmë të kuptojmë edhe shumë të vërteta të tjera jashtëgjuhësore për të, si p.sh. nivelin socio-kulturor të bartësve të saj, marrëdhëniet e tyre dhe rrjedhimisht të gjuhës që ata flasin me gjuhët e tjera, nivelin e lëvrimin të kësaj gjuhe dhe kompetitivitetin e saj, në kuptimin e aftësisë shprehëse në krahasim me gjuhë të tjera të kohës etj.

Autori thekson që në parathënie se hulumtimi i fjalëformimit emëror sekondar në shqipen e vjetër paraqet një nevojë urgjente jo vetëm për albanologjinë, të cilën ai në pasthënie e cilëson si një disiplinë shkencore më vete dhe plot vitalitet (duke pasur parasysh albanologjinë në hapësirën gjermanishtfolëse), por edhe për gjuhësinë historike e sinkronike në përgjithësi, për shkak se të dhënat për modelet emërore të fjalëformimit në shqipen e re në krahasim me gjuhët e tjera janë në fazën fillestare, kurse për shqipen e vjetër mungojnë fare. Veç kësaj, studimeve për shqipen moderne u ka munguar dimensionin historik, i domosdoshëm për të qartësuar siç duhet fenomenet.

Monografia ndahet në dymbëdhjetë kapituj, katër kapitujt e fundit përfshijnë pasthënie, bibliografinë, një listë të faqeve ku ndodhen shembujt prej veprave përkatëse të Buzukut, Bardhit, Budit, Bogdanit, Kuvendit të Arbënit, Lekë Matrëngës, Jul Varibobës e Codice Chieutino njëkohësisht me numrin e faqes ku janë cituar ata në studimin e Matzingerit, si dhe një listë të vetë shembujve.

Kapitulli i parë ose Hyrja sqaron parimet kryesore mbi të cilat është mbështetur punimi dhe mënyrën se si janë dhënë citatat nga shqipja e vjetër. Autori thekson se në qendër të hulumtimit nuk qëndrojnë njësitë e veçanta leksikore si pjesë e një inventari, por tërësia e rregullave në bazë të të cilave janë krijuar njësitë e reja. Në këtë vepër termi *fjalëformim emëror* u referohet emrave dhe mbiemrave jo të parrë, për sa u përket ndajfoljeve, ato do të trajtohen nga autori në studime të tjera (Matzinger 2016: 85, si argument sillat mungesa e kategorive gramatikore emërore te ndajfoljet si pjesë e pandryshueshme e ligjëratës). Po kështu, jashtë trajtimit mbeten formimet nëpërmjet ndryshimit të kategorisë sintaksore si p.sh. *i mirë* (mb.) > *të mirë* (em.), *kushtuom* “lëvdar” (pjesore) > *të kushtuom* (em.) me kuptimin “betim

i shenjtë”, për shkak të frekuencës së tyre shumë të lartë (Matzinger 2016: 80). Paraqitja formale e mënyrave të fjalëformimit është bërë sipas modelit të përpunuar nga Motsch për gjermanishten letrare të re.⁴ Si shkak për këtë paraqitet fakti se me këtë model strikt leksikor mund të paraqiten jo vetëm leksema të veçanta, por edhe modele të tëra fjalëformimi. Veç kësaj, ky model është neutral ndaj teorive të ndryshme. Asnjësisht ndaj teorive të ndryshme është sipas autorit e rëndësishme, sepse “das aus einer synchron-philologischen Behandlung des Textes extrahierte Datenmaterial zunächst systematisch aufgearbeitet und präsentiert werden muss, damit eine Grundlage geschaffen wird, auf der aufbauend weitere Überlegungen angestellt werden können. Gerade beim Altalbanischen muss eine solche zuverlässige Grundlage überhaupt erst geschaffen werden. Es wäre zum gegenwärtigen Zeitpunkt verfrüht und kontraproduktiv, versuchte man, das Material des Altalbanischen in das Korsett einer bestimmten, tagesaktuellen Wortbildungstheorie zu pressen” (të dhënat e nxjerra nga një vështrim sinkronik-filologjik i tekstit në fillim duhet të përpunohen dhe prezantohen sistematikisht, me qëllim që të krijohet një bazë mbi të cilën të mbështeten shtjellimet e mëtejshme. Një bazë e tillë e besueshme për shqipen e vjetër duhet fillimisht të krijohet. Në momentin aktual do të ishte e parakohshme dhe joproduktive po të bëheshin përpjekje që materialin nga shqipja e vjetër ta shtrëngonim në korsënë e një teorie të caktuar dhe aktuale fjalëformimi) (Matzinger 2016: 23 + shën. 24). Përsa u përket mbiemrave autori sqaron që shqipja ka dy klasa mbiemrash, me një dhe pa një të paravendosur. Këta të fundit janë formuar shpesh me prapashitesa prej një baze emërore ose foljore dhe vetëm konteksti e përcakton nëse kemi të bëjmë me emra apo me mbiemra (krh. p.sh. *plak*, *fisnik* < fis etj.). Por siç u tha, paraqitja e materialit në këtë vepër është bërë mbi bazën e modeleve të caktuara semantike, ku prania ose mungesa e nyjes së paravendosur nuk luan ndonjë rol.

Autorët e Vjetër citohen në bazë të botimeve diplomatike ose gjysmëdiplomatike. Buzuku citohet sipas transkriptimit të Resselit (1958) me disa modifikime të autorit. P.sh.: Fol. 95-95^v (318.1; Joh. 3.4) <sih mundeh lindeteh nierii teh dutene herre tue clene plach> *si mundë lindetë nierī të dytënë herrë tue klenë plak* Quomodo potest homo nasci cum sit senex ‘wie kann ein Mensch zweimal geboren werden, wenn er (doch) alt ist’ (Matzinger 2016: 25 + shën. 32).

⁴ Krh. Motsch, W. 2004. *Deutsche Wortbildung in Grundzügen* (Parimet kryesore të fjalëformimit në gjermanisht). Berlin/New York (botimi i dytë i përpunuar, i pari në vitin 1992). Gjermanishtja letrare e re (Neuhochdeutsch) është gjermanishtja e shkruar pas përkthimit të Biblës nga Martin Luteri dhe përfshin periudhën prej gjysmës së shek. XIV deri në kohën tonë. Më konkretisht për këto modele shih shpjegimet që jepen mbi kapitullin e pestë.

Në kapitullin e dytë me titull “Shqipja e vjetër dhe doracaku i përkujdesjes shpirtërore të Gjon Buzukut” jepen shkurtimisht dallimet kryesore midis dy dialekteve të shqipes, gegnishtes e toskërishtes, si dhe ndarja mbi bazë të ndryshimeve fonologjike e zhvillimit kronologjik të shqipes së lashtë ose arkaike në dy faza: periudha e *shqipes së lashtë të hershme* (gjerm. Frühuralbanisch) dhe periudha e *shqipes së lashtë të vonë* (gjerm. Späturalbanisch), që fillon prej vitit 167 p. e. s. me pushtimin romak dhe hyrjen e huazimeve latine e përfundon në vitin 1555 kur fillon shkrimi i shqipes. Periudha e së ashtuquajturës *shqipe e re* (gjerm. Neualbanisch) fillon në mes ose në fund të shek. XVIII. Ndarja në dy dialekte duhet të ketë ndodhur sipas Matzingerit (2016: 38) midis viteve 800-1000 të e. s. Në fund të këtij kapitulli rreshtohen veprat e letërsisë së vjetër shqipe që janë përdorur për krahasim. Këto janë, përveç Mesharit të Gj. Buzukut, të cilin autori e quan doracak të përkujdesjes shpirtërore, edhe veprat e P. Budit, Fjalori latinisht-shqip i F. Bardhit, “Çeta e profetëve” e P. Bogdanit, Fjalori dhe gramatika e At F. Maria da Lecces, Aktet e Kuvendit të Arbënit, Kodiku i Kieutit, “Doktrina e kërshen” e imzot Gj. Nikollë Kazazit dhe “Gjella e Shën Mëris Virgjër” e priftit arbëresh J. Variboba.

Kapitulli i tretë me titull “Turqizmat në doracakun e përkujdesjes shpirtërore” u kushtohet turqizmave të Mesharit, gjithsej tetë, dhe përfaqëson një kurorëzim të artikujve të botuar më përpara nga J. Matzinger dhe M. Genesin për këtë temë.

Në kapitullin e katërt me titull “Fjalësi dhe parimet e ndërtimit të fjalëve në shqipen e vjetër” pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur mënyrat e fjalëformimit në të folmen shqipe të Gj. Buzukut: prapashtesimi, si mënyra kryesore për formimin e emrave dhe mbiemrave edhe në shqipen e vjetër, parashtesimi, i cili del aktiv sidomos në formimin e foljeve, kompozimi dhe ndryshimi i kategorisë sintaksore që dallohet për frekuencë shumë të lartë. Me anë të këtij procesi të njohur edhe në gjuhë të tjera i. e., sipas autorit mund të krijohen vazhdimisht emra asnjans prej pjesoreve dhe mbiemrave, p.sh.: *i mirë* (mb.) > *të mirë* (em.), emri *të dëshmuometë* prej pjesores *dëshmuom* etj. Krh. lat.: *bonus* (mb.) > *bonum* (em.), përkatësisht *dictus* (pj.) > *dictum* (em.) (Matzinger 2016: 80-81). Autori nuk thellohet këtu rreth kësaj mënyre fjalëformimi dhe, siç e përmendëm më lart, vë në dukje që do ta trajtojë atë hollësisht një herë tjetër, por konstaton që përdorimi shumë i shpeshtë i saj bën që derivatet abstrakte prejfoljore dhe emërore të formuara me prapashtesa në shqipen e vjetër të jenë relativisht të pakta (Matzinger 2016: 81+ shën. 43). Në “Gramatikën e gjuhës shqipe” (2002: 147) emrat e tipit *të mirë* konsiderohen si formime me konversion, ndërsa emrat prejpjesorë të tipit *të folurit* si formime me paranyjëzim. Në këtë vepër autori nuk shprehet rreth

paranyjëzimit si mënyrë fjalëformimi në gjuhën shqipe. Mbetet të shohim çdo të thotë për këtë në studimet e ardhshme.

Në kapitullin e pestë me titull “Mbi përkufizimin dhe paraqitjen e materialit” autori sqaron termin “sekondar”. Sipas tij “Als sekundäres Lexikon werden alle Lexikoneinheiten definiert, die auf synchroner Sprachebene entweder durch ein phonologisch-morphologisch transparentes Ableitungsmorphem (Präfix oder Suffix) oder durch synchron transparente nominale Komposition von einer zu Grunde liegenden nominalen bzw. verbalen Basis abgeleitet sind und die deshalb als ‘merkmalhaltige Bildungen’ bzw. ‘motivierte Bildungen gelten’ (Si leksik sekondar përkufizohen të gjitha njësitë leksikore, të cilat në planin sinkronik të gjuhës janë formuar ose me anë të një morfeme fjalëformuese (prefiks ose sufiks) transparente nga pikëpamja fonologjike-morfologjike ose nëpërmjet kompozimit emëror, transparent në plan sinkronik, prej një baze emërore ose foljore dhe që për këtë arsye vlejné si ‘formime të markuara’, përkatësisht ‘formime të motivuara’ (Matzinger 2016: 85). Por në shënimin 2 ai saktëson se leksiku sekondar përfshin edhe nocione të tilla si lëvizje (ndryshim) kuptimi ose ndryshim kategorie, si dhe procese të tjera të ngjashme. Më tej ai sqaron konkretisht se si i ka zbatuar dhe adaptuar modelet e zhvilluara nga W. Motsch për shqipen e vjetër. P.sh. emrat *Arapī*, *Arbēnī*, *begatī*, *bukurī*, *diekēqī*, *fëlliqēnī*, *pleqēnī*, *shenjtēnī*, *vobēzī* vijnë përkatësisht nga mbiemrat *arap*, (*i*) *arbēnē*, *i* *begatē*, *i* *bukur*, *diekeq*, *i* *fëlliqm*, *plak*, *i* *shenjtēnē*, *vobeg* dhe përfshihen në modelin: [SM; PF_A - ò, -ënò, -ësò (f.), Pl. Ø], ku SM = modeli semantik, PF_A = forma fonologjike prej një baze mbiemërore dhe prapashtesat që i bashkangjiten asaj. Pra, fillimisht bëhet analiza semantike e fjalëve, pastaj analiza morfologjike, në vazhdim përcaktohet nëse modeli përkatës është ende aktiv apo jo, më tej vijnë shembujt nga Autorët e Vjetër dhe analiza etimologjike e sufiksit ose sufikseve përkatëse. Në fund jepet literatura e plotë për çdo pikë. Për shembujt nga Buzuku jepet në fillim citati origjinal, pastaj transkriptimi, teksti paralel latin dhe përkthimi në gjermanisht (shih më lart), ndërsa shembujt nga autorët e tjerë jepen zakonisht të transkriptuar dhe pa tekstin paralel latin. Siç dihet, shkenca gjuhësore ende nuk ka arritur të identifikojë tekstet latine që i shërbyen si bazë Buzukut për përkthimin e tij, megjithatë është bërë zakon që citate nga Meshari t’i krahasojmë me citatet përkatëse nga Bibla ose tekste të tjera fetare në latinisht. Lidhur me këtë Matzingeri me të drejtë tërheq vëmendjen duke e kritikuar traditën e krahasimit me botimet moderne latinisht të Biblës e teksteve të tjera fetare dhe kërkon që për krahasim të përdoren botimet bashkëkohore të Mesharit, pra ato përpara Konkilit të Trentos, sepse kjo, thotë ai, do të përbënte edhe hapin e parë në rrugën drejt identifikimit të teksteve bazë të përdorura nga Buzuku.

Kapitulli i gjashtë me titull “Modelet fjalëformuese të leksikut emëror sekondar në doracakun e përkujdesjes shpirtërore të Gjon Buzukut” është kryesori, sepse këtu analizohen modelet dhe mjetet fjalëformuese për formimin e emrave dhe mbiemrave që shfaqen në të folmet shqipe të përdorura nga Gj. Buzuku në krahasim me autorët e tjerë të vjetër të gjuhës shqipe. Ky kapitull ndahet në gjashtë nënkapituj dhe secili prej nënkapitujve përmban disa paragrafë. Tre nënkapitujt e parë trajtojnë çështjen e formimit të emrave me prapashtesa, duke nisur nga krijimi i emrave të veprimit dhe të vepruesit prej foljeve (nomina actionis dhe nomina agentis, si p.sh. *shërbes*, *ëndijesë*, *gjellë*, *dëshmi*, *durim*, *vetëtimë*, *ëndimë*, *duruos*, *çpërbles*, *andërrues*, *përderës*⁵, *mjelëse* etj.) deri te formimi i emrave prej mbiemrave (*qelbësinë* prej i qelbëtë, *bukurī* nga i bukur, *shkretëti* nga i shkretë etj.) dhe formimi i emrave prej emrave, si p.sh. *detorës* nga detuor, *gjakës* nga gjak, *peshkëtār* nga peshk, *udhëtār* nga udhë, *fajëtuor* nga emri asnjans faj/fajtë etj. Prapashtesat përkatëse janë: *-és*, *-ésë*, *-ë*, *-ī*, *-im*, *-imë*, *-më*, *-s*, *-e*.

Në nënkapitullin e tretë një paragraf i veçantë u kushtohet formimit të emrave të vendit me anë të prapashtesës *-éshtë*, si te *vëneshtë*, *kópështë* / *kópshhtë*, *vjéshtë* etj.⁶, po ashtu formimit të emrave kolektivë, si *anëmiqi* nga *anëmiq*, *famullī* nga *famull*, *djelmēnī* nga *djelm* ose *tregēti* nga *treg*. Vihet re një produktivitet i lartë i disa prapashtesave, siç është prapashtesa *-ī* me zgjerimin e saj *-ēnī* që vazhdon të jetë aktive edhe në gjuhën e sotme shqipe. Paragrafët në vazhdim merren me emrat e mocionit, përkatësisht me formimin e emrave të prejardhur femërorë prej atyre mashkullorë me anë të prapashtesave *-ëshë*, *-icë* dhe *-injë* (*mikeshë*, *profeteshë*, *buollicë*, *robinjë* etj.) dhe të atyre mashkullorë prej emrave femërorë me anë të prapashtesës *-án*, diçka krejt e rrallë jo vetëm për shqipen, por për të gjitha gjuhët indoevropiane. E vetmja fjalë e formuar në këtë mënyrë, *shtrigan* < *shtrigë* te Buzuku, e vërteton këtë. Më tej shqyrtohen prapashtesat që shërbejnë për formimin e emrave me kuptim zvogëlues a përkëdhelës, domethënë të diminutivëve, të cilët në fazat më të hershme të shqipes kanë qenë të shumtë.

Në nënkapitullin e katërt shqyrtohen prapashtesat, të cilat përndryshe te autorët e vjetër janë të rralla. Bëhet fjalë për prapashtesën me kuptim mohues *pā-* dhe formimin me anë të saj të emrave antonimikë prej mbiemrave e emrave. Në shqipen moderne kjo mënyrë për formimin e emrave është shumë e përhapur, kurse në shqipen e vjetër kufizohet vetëm në dy fjalë, *pādekēni*

⁵ Autori presupozon një temë *përderet* “lyp”, megjithëse nuk dëshmohet në shqipen e vjetër. Për shqipen e re krh. FGjSSH (Matzinger 2016: 157 + shën. 12). Ne jemi të mendimit që është një formim për analogji ose prapashtesim me *-ës* i shprehjes (*vete*) *derë për derë*.

⁶ Si temë te *vëneshtë* autori përcakton fjalën *venë*, ndërsa fjalët e tjerat janë nga pikëpamja sinkronike formime jotransparente (Matzinger 2016: 207).

prej *dekëni*⁷ me kuptimin *pavdekësi* në veprën “Çeta e profetëve” të P. Bogdanit dhe *e pāndēr* prej *ndēr* në kuptimin “çnderim” të “Rituale Romanum” e P. Budit. Ndryshe nga emrat, shumë i madh, 44 vetëm të Buzuku, është numri i mbiemrave me parashtesën *pā-* në të gjitha tekstet e vjetra shqipe të shqyrtuara nga Matzinger (p.sh. *i pā-frujt, i pā-krështenë, i pādenjë, i pāarrësye, i pāarmë* etj.). Këta mbiemra ai i përfshin në modelin [SM; PF_{N/A} (*i*) *pā-* ‘; Morphologie des Grundwortes/Morfologjia e fjalës bazë], ku N dhe A shënojnë bazën fonologjike prej emrash, mbiemrash e pjesorësh (Nomina + Adjektive), ndërsa analiza morfologjike tregon se parashtesa bashkohet me fjalën bazë, morfologjia e së cilës mbetet e pandryshuar. Në nënkapitullin e pestë ose të parafundit trajtohen kompozitat emërore, të cilat në shqipen e vjetër përbëhen prej dy elementësh. E rëndësishme është vërejtja e autorit (Matzinger 2016: 283) se në shqipen e vjetër gjejmë parimisht të gjitha tipet e kompozitave emërore që janë të zakonshme edhe për gjuhët e tjera të vjetra indoevropiane (si p.sh. *gjakafshë, manëmjedhërë, pjetëposhtë, mjesëditë, mjesënatë, dieq, zemërdëlirë* etj. të Buzuku).

Nënkaptulli i gjashtë dhe i fundit i kushtohet formimit të mbiemrave me anë të prapashtesave *-ār, -as, -ënë, -ërë, -m(ë), -shim, -shkë, -tār, -të, -uor* dhe të parashtesës *për-*, si p.sh. *kopështār, mortār, kelmendas, shenjtënë, i shkurtënë, i poshtërë, i sodm, i duruoshim, e zëshkë, burgëtār, i artë, i për-hërshim* etj. Meqenëse pjesa më e madhe e mbiemrave të formuar me këto prapashtesa përdoren edhe si emra, janë përfshirë këtu edhe mbiemrat e emëruar.

Në kapitullin e shtatë me titull “Fjalëformimi emëror sekondar i shqipes së vjetër: një përmbledhje” autori synon të nxjerrë disa përfundime duke na dhënë tre tabela shumë të vlefshme: në të parën pasqyrohet raporti midis prapashtesave shqipe të trashëguara prej gjuhës mëmë indoevropiane dhe atyre të huazuara prej latinishtes, sllavishtes dhe greqishtes pas periudhës klasike, pra pas shek. III (raporti është 15:8:7:3). Sigurisht, ky raport nuk është përfundimtar, sepse prejardhja e disa prapashtesave nuk është sqaruar ende përfundimisht. Por autori thekson që modelet e trashëguara mbizotërojnë dhe që raporti nuk ndryshon aspak prej atij në gjuhët e tjera të Evropës juglindore, si p.sh. në rumanishte. Tabela e dytë tregon aktivitetin ose frekuencën e përdorimit të prapashtesave, dhe e treta përmbajtjen semantike të tyre. Si prototip për formimin e emrave Matzingeri përcakton prejardhjen me anë të prapashtesave *-ō* (së bashku me variantin geg. *-ënō*, tosk. *-ërō* dhe variantin *-ësō*) dhe *-im*, të cilat e kanë ruajtur aktivitetin edhe në shqipen moderne, ndërsa të mbiemrave atë me prapashtesën (*i*)’*-shim*, në shqipen e

⁷ Konkretisht: U duk Jozefi dalë n’Burgut me Krip rruem të *dekënisë*, e veshunë së *pādekënije*, e bām mbë vend të Regjit ndëpër gjithë dhë të Misirit (Matzinger 2016: 263).

sotme (*i*)-*shëm*. Kompozitat, siç dihet, në shqipen e vjetër janë më të pakta në krahasim me formimin afiksial të emrave, por prej Rilindjes e këtej kompozimi përfaqëson një mënyrë aktive për formimin e emrave. Përfundimi i autorit është se në përgjithësi shqipja, prej dokumentit të parë të shkruar në mesin e shek. XVI e deri në ditët tona, përsa i përket fjalëformimit emëror, funksionon si një gjuhë indoevropiane tipike e Kohës së Re, e krahasueshme p.sh. me gjermanishten e lartë të re. Kjo do të thotë që prejardhja parashtesore dhe prapashtesore, së bashku me kompozimin, përfaqësojnë mënyrat fjalëformuese kryesore gjatë një periudhe të dokumentuar gati 500-vjeçare (Matzinger 2016: 391-392).

Kapitullin e tetë dhe të fundit me titull “Shembujt në tërësi” e përbën fjalori i të gjitha formimeve emërore e mbiemërore në Mesharin e dom Gj. Buzukut, me ubikacionin dhe kontekstin e duhur në origjinal plus fjalën përgjegjëse në latinisht. Në këtë mënyrë ky studim mund të konceptohet edhe si i ndarë në dy pjesë: në pjesën e parë që analizon një nga një modelet fjalëformuese në librin e parë shqip dhe në pjesën e dytë që parashtron në tërësi materialin, domethënë emrat e mbiemrat e këtij libri të formuar sipas modeleve fjalëformuese të shqyrtuara në pjesën e parë. Për shkak të kësaj pjese të dytë (149 fq. gjithsej) studimi mban edhe nëntitullin “Një ndihmesë për leksikografinë e shqipes së vjetër”, sepse ky punim, siç sqaron autori, u nis me këtë qëllim.

Personalisht e vlerësoj shumë daljen e kësaj vepre duke qenë se gjithmonë e kam konsideruar fjalëformimin si një nga nënsistemet më të rëndësishme të gjuhës shqipe e sidomos asaj standarde. Fjalëformimi ka qenë edhe një nga temat kryesore në studimet e mia për gjuhën shqipe, prej të cilave i fundit sapo ka dalë dhe analizon pikërisht burimin dhe strukturën fjalëformuese të termave fetarë të përdorur në Meshar (krh. Arapi 2015). Terminologjia fetare është një nga fushat më të rëndësishme të leksikut buzukjan, duke ditur se bëhet fjalë për një vepër me karakter liturgjik, prandaj nëpërmjet saj mund të shqyrtohen fare mirë e në mënyrë përfaqësuese elementet përbërëse të sistemit fjalëformues në gjuhën shqipe të kësaj vepre. Edhe këtu duket qartë se, sipas autorit, mënyra kryesore për fjalëformimin emëror në leksikon buzukjan është substantivimi, domethënë formimi i emrave prej pjesoreve e mbiemrave nëpërmjet ndryshimit të kategorisë leksikogramatikore, si p.sh.: *të besuomit* prej pjesores *besuom* (krh. me *të besuomit* tat me besimin tënd”, fol. 24, Oratio), e provoi *të pābesënë* e tyne „e provoi pabesinë e tyre” (fol. 79, Marku 16:14) prej mb. *i pabesë* etj. Duke pasur parasysh që në shqipen moderne jo ndryshimi i kategorisë sintaksore/leksikogramatikore, por afiksimi dhe kompozimi janë mënyrat kryesore të fjalëformimit, arrijmë në përfundimin e J. Matzinger se në këtë pikë shqipja ka ardhur duke u zhvilluar si një gjuhë indoevropiane moderne, ku sipas mendimit tonë një rol të

rëndësishëm ka luajtur edhe hapja e saj ndaj gjuhëve të tjera, për shkak se një pjesë e këtyre afiksve janë të huazuara e vazhdojnë të huazohen edhe sot e kësaj dite prej gjuhëve të huaja. Kështu shqipja është larguar gjithmonë e më tepër nga një mënyrë tipike e brendshme fjalëformuese drejt mënyrave e mjeteve më të përgjithshme duke u ndërkombëtarizuar.

Vepra e re e gjuhëtarit austriak J. Matzinger është njëkohësisht edhe një kontribut për etimologjinë shqipe e pikërisht për atë pjesë të saj që lidhet me shpjegimin e zhvillimit historik të ndajshesave fjalëformuese të kësaj gjuhe. Ishte një domosdoshmëri, thekson autori në parathënie, për shkak se interpretimet mbi diakroninë e afikseve shqipe, mbështeten në të dhënat e shqipes moderne dhe nuk marrin parasysh dokumentet e vjetra të saj. Në këtë fushë, ku rezultatet e deritanishme janë pjesërisht të vjetëruara e madje të gabuara, ai na sjell mjaft propozime të reja. Prej tyre më sfiduese janë ato që presupozojnë burimin e disa prapashtesave prej greqishtes, sepse kjo do të kërkojë një rivlerësim të lidhjeve gjuhësore shqiptaro-greke. Sipas Matzingerit, edhe kompozitat emërore në shqipen moderne duhet të jenë zhvilluar nën ndikimin e sllavishtes jugore e të greqishtes (Matzinger 2016: 318).

Së fundi, siç thekson edhe autori në pasthënie, ky studim së bashku me atë të W. Fiedlerit për sistemin foljor kanë hulumtuar tashmë me hollësi dy komponente bazë të së folmes gege të vjetër të dom Gjon Buzukut.

BIBLIOGRAFI

- Arap, I. 1990. *Tipat strukturorë të mbiemrave në veprën “Çeta e Profetëve” të Pjetër Bogdanit*. Në: “Studime filologjike”, 1990/1. Tiranë, f. 41-56.
- Arap, I. 2010. *Togfjalëshat e qëndrueshëm si mënyrë për formimin e emrave në gjuhën shqipe*. Në: Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare. Materialet e punimeve të Seminarit XXIX ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare (Prishtinë, gusht 2010). Prishtinë, f. 97-107.
- Arap, I. 2012. *Albanisch - rumänische Parallelen im Bereich der Wortbildung: Die Suffixe*. Në: Wolfgang Dahmen, Günter Holtus, Johannes Kramer & alii (botues). Südosteuropäische Romania. Siedlungs- / Migrationsgeschichte und Sprachtypologie. Romanistisches Kolloquium XXV. Tübinger Beiträge zur Linguistik. Narr Verlag. Tübingen, f. 123-152.
- Arap, I. 2015. *Cu privire la crearea lexicului liturgic în limba albaneză - originea termenilor creștini în Liturghierul lui Ion Buzuku (1555) / Mbi krijimin e leksikut liturgjik në gjuhën shqipe - origjina e termave fetarë në Mesharin e Gjon Buzukut (1555)*. Në: Aktet e Simpoziumit V Ndërkombëtar “Explorëri în Tradiția Biblică Românească și

- Europeană” / Hulumtime në traditën biblike rumune dhe evropiane. Jash, 12 -14 nëntor 2015.
- Çabej, E. 2006. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. *Studime etimologjike në fushë të shqipes*. Bleu VII. Tiranë.
- Gramatika e gjuhës shqipe 1*. 2002. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Tiranë.
- Hysa, E. 2004. *Formimi i emrave me ndajshesa në gjuhën shqipe*. Tiranë.
- Matzinger, J. 2016. *Die sekundären nominalen Wortbildungsmuster im Altalbanischen bei Gjon Buzuku*. Ein Beitrag zur altalbanischen Lexikographie. Albanische Forschungen 38. Wiesbaden. Harrasowitz Verlag.
- Ressuli, N. 1958. *Il “Messale” di Giovanni Buzuku. Riproduzione e trascrizione*. Città del Vaticano. Biblioteca Apostolica Vaticana.
- Shuteriqi, Dhimitër S. 1976. Akademia e Shkencave e RP të Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë. *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*. Tiranë.

